



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 1063 / Prot.
1

Tiranë, më 8.11.2019

Lënda: Mendim mbi një projekt-marrëveshje ndërinstitucionale

Z. PLARENT NDRECA
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
MINISTRIA E BRENDSHME

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj nr.7440/2, datë 18.10.2019, me anë të së cilës kërkohet mendim mbi projekt-marrëveshjen ndërinstitucionale “Ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë, Ministrisë së Brendshme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Ministrisë së Brendshme të Republikës së Kosovës, për forcimin e bashkëpunimit në fushën e sigurisë së kufirit”, Zyra e Komisionerit vlerëson të nevojshme marrjen në konsideratë të parashikimeve të ligjit nr.9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Projekt-marrëveshja në përmbushje të qëllimit të saj, parashikon përpunim të të dhënave personale, veprim në të cilin përfshihet shkëmbimi/transferimi ndërkombëtar i të dhënave midis palëve nënshkruese. Përpunimi i të dhënave kërkon reciprokisht nga palët, zbatimin e disa parimeve ligjore dhe masave garantuese me qëllim legjitimitetin e këtij procesi nga njëra anë dhe mbrojtjen e të drejtave të subjekteve të të dhënave personale nga ana tjetër.

Arritja e nivelit të mbrojtjes së të dhënave personale nga palët nënshkruese është kusht i domosdoshëm në transferimin ndërkombëtar të të dhënave.

Për sa më sipër, në nenet 8 dhe 9, të ligjit nr.9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar parashikohen rregullat e transferimit ndërkombëtar të të dhënave personale.

Komisioneri në zbatim të këtyre neneve ka miratuar, Vendimin nr.8/2016 “Për përcaktimin e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave

personale”, si dhe Udhëzimin nr.41/2014 “Për lejimin e disa kategorive të transferimeve ndërkombëtare të të dhënave personale në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”.

Në këtë rast, Republika e Kosovës nuk bën pjesë ndër shtetet e listuara në Vendimin e sipërpërmendur.

Pavarësisht këtij fakti, Udhëzimi nr.41/2014 (*bazuar në pikën 2, të nenit 8 dhe pikën 3, të nenit 9, të ligjit nr.9887/2008, i ndryshuar*) parashikon rastet sipas të cilëve transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale, mund të realizohet pa autorizim të Komisionerit, në vende me nivel jo të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale.

Në këto kushte, kur njëra nga palët nënshkruese nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale, nënshkrimi dhe zbatimi i kësaj Marrëveshje duhet të gjejë mbështetje në një nga parashikimet e pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr.9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar ose në të kundërt të paraqitet kërkesë për autorizim te Komisioneri, mbështetur në pikën 4, të nenit 9, të ligjit nr.9887/2008, i ndryshuar.

Me përfshirjen e parashikimeve të sugjeruara më sipër, projekt-marrëveshja plotëson kushtet ligjore për përpunimin e drejtë dhe të ligjshëm të të dhënave personale dhe si e tillë do të vlerësohet e hartuar konform ligjit nr.9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

